



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 384, Datë 28.12.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 187, DATË 10.11.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E
SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 72/10 prot., datë 20.12.2023, të Drejtorive Teknike të ERE-s, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-S nr. 188 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar ,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 184, datë 29.05.2023, ka vendosur të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:
(1) “Të licencojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.08.2023, të depozitojë në ERE Certifikatën e Sigurimit.”
- ERE njoftoi shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. për këtë vendim nëpërmjet shkresës nr. 72/4 prot., datë 01.06.2023, duke i evidentuar dhe detyrimin për të depozituar në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 72/5 prot., datë 21.08.2023, shoqëria “ALBGAZ” sh.a., ka parashtruar se aktualisht ndodhet në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të sistemit të shpërndarjes së gazit natyror e në referencë të plotësimit të kushtit të këtij vendimi, ka kërkuar shtyrjen deri në rifillimin e kryerjes së aktivitetit, të afatit për depozitimin e Certifikatës së Sigurisë.

- Për të sqaruar më tej kërkesën e shoqërisë, ERE, me shkresën nr. 72/7 prot., datë 26.09.2023, ftoi përfaqësuesit e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në ambientet e ERE-s më datë 03.10.2023.
- Sqarimet e dhëna në seancë u depozituan në vijim nga shoqëria në ERE me shkresën me nr. 72/8 prot., datë 24.10.2023.
- Shoqëria argumenton se ka pajtuar konsulent ndërkombëtar për të hartuar raportin e inventarizimit të aseteve, ku ndër të tjera në këtë raport evidentohet se tubacionet janë jashtë standardeve teknike, për shkak edhe të avarive, ka pengesa në gjurmë etj. Po ashtu, sa deklaruar nga shoqëria dhe referuar pasqyrave financiare të 3 viteve të fundit, për shkak të mungesës së kërkesës, shoqëria “ALBGAZ” sh.a. nuk ka patur aktivitet në fushën e gazit natyror.
- Për sa më sipër, shoqëria kërkon që afati i realizimit të pajisjes me Certifikatën e Sigurimit të zgjatet për një afat 3-vjeçar, duke nisur nga fillimi i punimeve të tubacionit.
- Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 44.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se *“Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”*

Në mbështetje të sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të plotësimit të dokumentacionit përkatës është depozituar përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 184/2023 dhe duke marrë parasysh përpjekjet e “ALBGAZ” sh.a. për të plotësuar këtë kusht vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet, duke i lënë kusht asaj që të depozitohet në ERE Certifikatën e Sigurimit 1 (një) muaj përpara vënies në operim. 1

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:
(1) “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që të depozitohet në ERE Certifikatën e Sigurimit, 1(një) muaj përpara vënies në operim”
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI